

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-002/15**

**Prishtinë  
12 Tetor 2016**

**Në çështjen juridike të:**

**V. K.**  
Pejë

**Paraqitësi e ankesës**

Në emër të paraqitësit të kërkesës  
**V. K.**

**Kundër**

Askush

**Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Sylejman Nuredini Kryetar i Kolegjit, Gjyqtarët Krassimir Mazgalov dhe Beshir Islami anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/204/2013 lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrin KPA17840 i datës 11 Qershor 2013, pas seancës gjyqësore të mbajtur më 12 Tetor 2016, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Ankesa e V. K. e paraqitur kundër vendimit të KPCC /D/A /204/2013 sa i përket lëndës së regjistruara në AKP me numrin KPA 17840 i datës 11 Qershor 2013, hudhet si e pasafatshme

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 18 Janar 2007, V. K., ka parashtruar një kërkesë në AKP e regjistruar në nr. KPA17840, në cilësinë anëtarit të familjës së titullarit të së drejtës pronësore. Prona e kërkuar gjendet në parcelën nr. 1, zona kadastrale Barane, Komuna e Pejës me sipërfaqe prej 06 19 26 ha. Ai ka pohuar se nëna e tij S. F. ( gjykata vëren se në kërkesë është S. ndërsa në dokumenta civil S) si bartëse e së drejtës pronësore tani e ndjerë është pronare e paluajtshmërisë që gjendet në fshatin Barane, Komuna e Pejës, me kulturë mal. Në kërkesë ai ka pohuar se nëna e tij e ndjerë ka filluar një kontest gjyqësor me Ndërmarrjen Publike për Bujqësi dhe Pemtari “Barane” në vitin 1961, proces i cili nuk ka përfundur sipas pohimit të paraqitësit të kërkesës. Paraqitësi i kërkesës V. K. kishte ndërruar jetë më 06 Nëntor 2012 dhe në emër të tij në cilësinë e anëtarit të familjes V. K. kishte parashtruar ankesë kundër Vendimit të Komisionit
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij i ndjeri V. K. ka paraqitur në AKP dokumentet si në vijim:
  - Letërnjoftimin të lëshuar nga Sekretariati i Punëve të Brendshme në Pejë dt.24.03.1989
  - Parashtrëse Gjyates së Qarkut në Pejë për zgjerimin e padisë G.Br. 206/60 nga bartësi pretendues i së drejtës pronësore pa vulë pranimi në gjykatë.
  - Letërnjoftim lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës, Prishtinë(dokumeni i paraqitur nga parashtruesi i ankesës).
  - Korrespondence me Sektorin e çështjeve pronësore të Republikës së Serbisë
3. Ekipi i verifikimit i AKP-së bazuar në raportit të verifikimit të datës 06 Shtator 2012, ka konstatuar që sipas Fletës Poseduese të theksuar prona e kërkuar është regjistruar si pronë

shoqërore dhe se i është nënshtruar administrimit nga Agjencia Kosovare Mirëbesimit tani Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe si e tillë i është nënshtruar procesit të privatizimit dhe dhënies me qira për 99 vite. Pas përfundimit të procesit prona e kërkuar nga Agjencia e Mirëbesimit ka kaluar në shfrytëzim të Rr. Sh. përmes dhënies me qira.

4. Më 04 Mars 2009, AKP-ja kishte identifikuar pronën e kërkuar duke vendosur një shenjë në vendin ku gjendej prona. Në raportin e saj të Identifikimit, ekipi i AKP-së kishte shënuar se prona ishte mal dhe e pa okupuar. Identifikimi i pronës ishte kontrolluar dhe krahasuar bazuar në koordinatat e GPS-it dhe ortofoton dhe ishte konstatuar se ai ishte bërë në mënyrë të saktë.
5. Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) në lidhje me pronat e kërkuara, me vendimin e saj KPCC/203/2013 që i referohet lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA 17840 i datës 11 Qershor 2013 ka vendosur që kërkesa refuzohet, me arsyetim se paraqitësi i kërkesave fillimisht kishte deklaruar se e ka humbur poshdimin si pasojë e konfliktit të armatosur por në bazë të dokumentave të parashtruara dhe kërtimeve “ex officio” të Sekretariatit ka rezultuar se prona nuk është humbur si pasojë e konfliktit apo rrethanave që ndërlidhen drejtëpërsëdrejti apo rezultojnë nga konfliktit.

#### **Pretendimet ankimore:**

6. V.K. në cilësinë e palës ankuese, djali i parashtruesit të kërkesës, tani të ndjerë, e ka pranuar vendimin e Komisionit më 11 Dhjetor 2013, ndërkaq ankesë ka paraqitur më datë 08 Shtator 2014.
7. Paraqitësi i ankesës pretendon se ai nuk ka mundur ta sigurojë dokumentacionin përkatës por pohon se ekziston dokumentacioni që vërteton se prona e kërkuar i takon familjës K. dhe këtë mund ta dëshmojnë edhe fqinjët që kanë pronat e tyre ngjitur me pronën e kërkuar. Me gjithë kërkesat e përseritura të Sekretariatit Ekzekutiv të AKP-së parashtruesi i ankesës nuk ka paraqitur dokumenta që dëshmojnë pretendimet ankimore. Sekretariati i Agjencisë ka kërkuar shkresat e lëndës civile G.Br. 206/60 por nuk janë gjetur në arkivin e gjykatës përkatëse.

#### **Arsyetimi ligjor**

### **Pranueshmëria e ankesave:**

8. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore sipas nenit 194 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi procedurën kontestimore (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2008) (në tekstin e mëtejme LPK), Gjykata lidhur me shqyrtimin e aktgjykimit sipas detyrës zyrtare dhe për shkaqet e cekura dhe jo të cekura në ankesë gjeti se:

### **Ankesa është e pasafatshme.**

9. Gjykata Supreme e Kosovës e hodhi ankesën e ankueses si të pasafatshme sipas nenit 186 par. 1 lidhur me nenin 196 të LPK-së. Kjo ngase, se V. K. në cilësinë e ankueses vendimin ankimor e ka pranuar më 11 dhjetor 2013, ndërkaq ankesë ka paraqitur më datë 08 Shtator 2014
10. Gjykata në shkresat e lëndës gjeti se dërrëzimi i vendimit të Komisionit tek parashtruesi i ankesës është bërë në përputhje me nenin 111.1 të LPK-së që parasheh mundësinë e dorëzimit të shkresave anëtarit të familjës të moshës madhore.
11. Paraqitësi i ankesës nuk ka cekur në ankesë asnjë rrethanë që e ka pamundësuar që ai të ushtroi mjetin ligjor me në afat.
12. Nga kjo mund të konstatohet se ankesën e ka paraqitur pas afatit prej 30 ditësh të parashikuar me dispozitën e nenit 12 par. 1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79. Me këtë dispozitë ligjore parashikohet se ankesa kundër vendimit të KPCC mund të ankimohet brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit.
13. Rrjedhimisht sipas dispozitës së nenit 13 par. 3 nënpar. b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79 ,duke hedhur ankesën si të pasafatshme, Gjykata nuk ka shqyrtuar meritat e ankesës por ka vendosur si në diapozitiv të këtij aktgjykimi

### **Këshillë ligjore:**

14. Sipas 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetare e Kolegjit,**

**Beshir Islami, Gjyqtar**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtare e EULEX-it**

**Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it**